

V E N D I M
Nr. 327, datë 27.6.2002

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.726, DATË 21.12.2000 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE”, ME
NDRYSHIMET PËRKATËSE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 dhe 6 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në lidhjen I “Renditja e funksioneve sipas klasifikimit” të vendimit nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave, ndryshuar me vendimet përkatëse, të bëhen këto ndryshime:

- Në klasën B4 emërtesa “Shef i sektorit të prokurimit dhe shef i sektorit të kontrollit në Agjencinë e Prokurimit Publik” zëvendësohet me “Përgjegjës sektori në Agjencinë e Prokurimit Publik”.

- Në klasën C2 emërtesa “Specialist në sektorin e prokurimit dhe specialist në sektorin e kontrollit në Agjencinë e Prokurimit Publik”, zëvendësohet me “Specialist, inspektor në Agjencinë e Prokurimit Publik”.

2. Të gjitha dispozitat ligjore që bien në kundërshtim me këtë vendim shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko